

VETËVENDOSJE!

KOPJIMI LEJOHET.
TË LUTEM KOPJOJE!

GAZETË JAVORE | 18 tetor 2005 | nr. 9 | www.vetevendosje.org

Kai Aide kundër vullnetit të popullit të Kosovës

Shkëlzen Gashi

Në letrën që Kofi Anan, Sekretar i Përgjithshëm i OKB-së, ia ka dërguar Kryetarit të Këshillit të Sigurimit, Minea Joan Motok, ndër të tjera, thotë: siç e dini, unë e kam emëruar ambasadorin Kai Aide emisar timin të posaçëm për të kryer një raport gjithëpërfshirës të gjendjes në Kosovë (Serbi dhe Mal i Zi). Pra, sipas Ananit, Kosova është pjesë e Serbisë dhe Malit të Zi. Por, jo vetëm kaq. Më tutje ai thotë se qëllimi i këtij raporti ishte për të vlerësuar nëse ka kushte për të hyrë në një proces politik të disenjuar për ta caktuar statusin e ardhshëm të Kosovës, në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Rrjedhimisht, sipas Ananit, Kosova jo vetëm që është pjesë e Serbisë dhe Malit të Zi, por edhe duhet të mbetet e tillë sepse Anan po propozon që statusi i ardhshëm të jetë në përputhje me Rezolutën 1244.

Përshkrimi i punës i të dërguarit të posaçëm të sekretarit të përgjithshëm, Kai Aide, është që të shqyrtojë në mënyrë gjithëpërfshirëse gjendjen në Kosovë në kontekst të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së. Kështu që, raporti s'mund të jetë në shpërputhje me përshkrimin e punës. Në vijim të kësaj, që në fillim të raportit të tij, Aide thotë se konsideratat dhe rekomandimet e mëposhtme paraqesin gjykimin tim më të mirë se ku gjendemi dhe se si do të duhej të vazhdonim në përputhje me Rezolutën 1244 të Këshillit të Sigurimit.

Pika 34 thotë se Shërbimi Policor i Kosovës (SHPK) gradualisht po merr detyra të reja dhe që kërkojnë më shumë, përfshirë kontrollin e trazirave (stërtheksimimi - Sh.G). Kurse pika 40 vërteton se SHPK nuk do të jetë e pavarur ngase, në bazë të raportit, edhe më tutje do të ketë nevojë për një prezencë të vazhdueshme të policisë ndërkombëtare me fuqi ekzekutive në sferat e ndjeshme. Ndërsa pika 25 thotë se TMK (Trupa Mbrojtëse e Kosovës) ka vazhduar të përmirësohet në përbushjen e mandatit të saj, si një organizatë civile për emergjencë. Gjeneral Agim Çeku pas një takimi me Bot De Margnak në Mitrovicë, ka deklaruar se raporti i Aides sugjeron atë çka TMK-ja praktikisht e synon. A synon TMK-ja të trajtohet si një organizatë civile për ndërhyrje emergjente, e që s'ka të drejtë të përzihet në çështje të rendit dhe sigurisë publike?!...

Pika 67 thotë se është me shumë rëndësi që procesi i statusit të ardhshëm të ndodhë në kohën kur komuniteti ndërkombëtar është ende prezent në Kosovë, dhe në forcë të mjaftueshme. Rëndësia e pranisë së forcave ndërkombëtare në Kosovë gjatë definimit të statusit të Kosovës është indikator se zgjidhja e statusit do të jetë në kundërshtim me vullnetin e popullit të Kosovës. Ky raport është i dëmshëm për Kosovën dhe i favorshëm për Serbinë, edhe për arsyen se sipas raportit, pos Beogradit dhe Prishtinës, serbët e Kosovës do të duhet të adresohen gjithashtu si palë në këtë proces. E, kjo iu mundëson serbëve të Kosovës që të realizojnë autonominë territoriale në kuadër të Kosovës, e Kosovës autonomi substanciale në kuadër të Unionit Serbi-Mali i Zi. Edhe pika 72 dëshmon se ky raport është në kundërshtim me



Foto: Rrezeart Galica - Ciqi

vullnetin e popullit të Kosovës, sepse në këtë pikë thuhet se rezultati përfundimtar i statusit të ardhshëm të Kosovës duhet t'i kontribuojë stabilitetit rajonal. E, dihet mirëfilli se stabiliteti rajonal sipas Grupit të Kontaktit dhe Këshillit të Sigurimit të OKB-së, ruhet vetëm duke mos u ndryshuar kufijtë shtetëror në Ballkan.

Pika 80 thotë se BE-ja duhet të shqyrtojë rritjen e pranisë së saj në Kosovë, me qëllim që të lozë një rol më të madh në procesin e standardeve. Kur të përcaktohet statusi, prej BE-së pritet që të ndërmarrë rol edhe më të madh në fushën e policisë dhe drejtësisë. NATO-ja po ashtu duhet të vazhdojë me praninë e saj thuhet në pikën 81. Ndërkaq, pika 86 thotë se Kosova megjithatë do të vazhdojë të varet nga një prani e konsiderueshme ndërkombëtare e stacionuar në Kosovë. Hyrja në procesin e statusit të ardhshëm nuk nënkupton hyrjen në fazën e fundit, por në fazën e radhës së pranisë ndërkombëtare. Pikat e përmendura në këtë paragraf dëshmojnë mjaft mirë se Kosova nuk do të jetë shtet i pavarur dhe sovran.

Kryeministri i Kosovës, Bajram Kosumi, në fjalimin e mbajtur më 19 maj 2005 në mbledhjen e Kuvendit të Kosovës, pat thënë se 'decentralizimi nuk është koncipuar për të bartur konsekuenca negative territoriale për Kosovën, dhe se nuk do të ketë enklavizim të ri të territorit të komunave'. Qëllimi i decentralizimit ka qenë dhe është legalizimi i enklavizimit ekzistues. Legalizimi i të ashtuquajturave 'struktura paralele'. Se përmes decentralizimit synohet legalizimi i strukturave paralele, vërehet fare qartë edhe në raportin e Kai Aides, përkatësisht në pikën 60 të raportit, ku thuhet se decentralizimi duhet të shqyrtohet seriozisht në një kornizë më të gjerë, e cila kornizë do të mund të përfshinte një numër komunash të reja ku në veçanti serbët e Kosovës do të kishin shumicën e theksuar. Kjo, gjithnjë sipas raportit të Aides, do të mund të parashihte kompetenca të shtuara për këto komuna në sferat si policia, drejtësia, arsimi, kultura, media, ekonomia... dhe ky proces do të mund të lejonte lidhje horizontale midis komunave me shumicë serbe, me mundësinë që të shqyrtohen po ashtu edhe modalitetet për lidhje të posaçme

të këtyre komunave me Beogradin.

Është shqetësuese përmbajtja e raportit të Aides. Por edhe më shqetësuese janë deklaratat e zyrtarëve të IPVQ-ve dhe partive politike. Muhamet Hamiti, zëdhënës i Presidencës së Kosovës, ka thënë se 'ka pritje që raporti të shtronte rrugën për ta përmbyllur çështjen e statusit të Kosovës, e kjo ka ndodhur dhe kjo ka rëndësi'. Është shumë e vërtetë se me këtë raport është shtruar rruga për ta përmbyllur çështjen e statusit të Kosovës, por në përputhje me Rezolutën 1244. Kurse çmeritëse është deklarata e zëdhënësit të partisë në 'pushtet', AAK-së, Ernest Luma, i cili e ka vlerësuar raportin e Kai Aides 'si shumë real dhe që do ta çojë përpara procesin për fillimin e bisedimeve për statusin final të Kosovës. Për më keq se kaq, ai ka shtuar se të 86 pikat e raportit paraqesin vullnetin e popullit të Kosovës'.

Ndërsa lideri i PDK-së, Hashim Thaçi, ka thënë se raporti i Aides është real dhe i pranueshëm për partinë që e drejton ai. Thaçi edhe është për raportin e Aides, por edhe është kundër negociatave me Beogradin - nuk është e rëndësishme që raporti i Aides parasheh negociatave me Beogradin. Thaçi është për negociatave me bashkësinë ndërkombëtare për të definuar modalitetet e bërjes së Kosovës shtet - edhe pse bashkësia ndërkombëtare është për negociatave me Beogradin dhe Prishtinës, dhe pikërisht për këtë do të emërojë një ndërmjetësues ndërkombëtar, me gjasë Marti Ahtisarin. E tash, shrohet pyetja, a ka logjikë që të ketë negociatave mes Kosovës dhe bashkësisë ndërkombëtare, dhe përkatësisht me këtë, Kosova të formojë grup negociator, kurse bashkësia ndërkombëtare të emërojë ndërmjetësues?! Thaçi është kundër decentralizimit dhe është për raportin e Aides - nuk ka lidhje që ky raport propozon që të intensifikohet procesi i decentralizimit. Thaçi kundërshton që Kosova të përfaqësohet edhe nga një delegacion i serbëve të Kosovës në njërin anë, ndërsa në anën tjetër është për raportin e Aides - ani se ky raport parasheh që serbët e Kosovës të adresohen gjithashtu si palë në këtë proces. Ka dy mundësi: Thaçi ose s'e ka lexuar fare raportin e Aides, ose është mashtrues i pakundshoq!

Popullata vendëse nuk ka zgjidhje tjetër: robërinë ose sovranitetin.
Zhan Pol Sartër

Editorial

Kur një sistem politik është në shpërputhje me vullnetin dhe interesat e të qeverisurve, ai pushtet është jodemokratik. Kjo shpërputhje bën që parakushti i mbijetesës së një regjimi të kësillojtë të jetë ushtrimi i inxhinieringut për rrënjosjen e iluzioneve dhe përhapjen e mashtrimeve te populli i qeverisur padrejtësisht. Në mënyrë që padrejtësia të ndërlikohet deri në atë masë, sa qytetari t'i bëhet e pakapshme drejtpërdrejt. Sepse, përndryshe, tejdukshmëria asaj do t'i bëhej varr.

Gjithçka është bërë deri sot nga UNMIK-u, ka një emër: sofistikim i padrejtësisë. Tërë ditën flasim për institucionet tona, por rrallë shohim kufijtë e tyre të imponuar. Na detyrojnë të zgjedhim gjithçka përbrenda këtyre institucioneve, përveç koordinatave të tyre politike. Pra, zgjedhim çdo gjë tjetër me përjashtim të thelbit. E, ky thelb është liria që na duhet.

Vullneti i popullit jo vetëm që po shtypet. Ai tashmë është transformuar aq shumë, sa u degjenerua në pozicionin fillestar të kërkesave të delegacionit kosovar për negociatave të padrejta me shtetin e Serbisë për lirinë tonë kolektive! Vullneti i popullit u bë opsion, sa për t'iu garantuar përjashtimi. Nga një pozicion me vlerën e domosdosisë, ai u shndërrua në njërin prej mundësive të shumta. Kjo mundësi, madje edhe teoritikisht u bë pamundësi, kur Peterseni qartësoi përfundimisht qëllimin themelor të negociatave: kompromisin. Vullneti i popullit si opsion, dhe kompromisi si qëllim janë në kundërshtim fundamental. Nëse përfundimi i bisedimeve si qëllim esencial kërkohet ta ketë kompromisin, si qenka e mundur arritja e diçkaje që si opsion është e pakompromis? Shumë e qartë: vullneti i popullit, pra, në gojën e krejt armatës së zyrtarëve të huaj, nuk shërben asgjë më shumë se sa një biberon - mjet i domosdoshëm i qetësisë të pakënaqësive popullore gjithnjë e në rritje.

Pjesë e këtij inxhinieringu janë edhe vetë liderët politikë kosovarë. Aq të robëruar janë ata, saqë më nuk do të mund të vendosin jo vetëm çka të pranojnë, por as çka të refuzojnë. Në një situatë të tillë për të të ardhur keq, le ta kuptojmë gjithë pompozitetin e diskursit të tyre, si përpjekje për minimizimin e veprimeve të dëmshme që po i bëjnë vendit. Meqë është në natyrën e bisedimeve të padrejta që rregullisht të përftojnë zgjidhje të padrejta, s'do mend që gjuha e tyre do të vazhdojë e tillë edhe në të ardhmen.

Një gjë të tillë duhet ta parandalojë vetë populli. Sepse nëse populli u lejon atyre të ardhme, kjo është humbja e të ardhmes së tij.

Glauk Konjufca

Krahasim midis Kosovës dhe Serbisë - disa të dhëna elementare

	KOSOVA	SERBIA
TË PËRGJITHSHME		
Sipërfaqja territoriale	10.887 km ²	77.474 km ²
Popullsia	2,1 milionë	7,5 milionë
Qyteti më i madh	Prishtina (përafërsisht 400.000 banorë).	Beogradi (1,5 milionë banorë).
POLITIKA		
Regjimi politik	Demokraci procedurale, mbikëqyrje dhe kontroll nga UNMIK-u në fushat e rezervuara të pushtetit (policia, drejtësia, punët e jashtme).	Demokraci procedurale, sovranitet i plotë, përpos në punët e jashtme (ushtrohet nga unioni SMZ).
Statusi shtetëror	Territori i administruar nga OKB-ja.	Republikë konstituive dhe dominanta e SMZ-së (SMZ është shtet i njohur ndërkombëtar me anëtarësi të plotë në OKB).
Shërbimi ushtarak	Nuk ka. (e kontrolluar nga forcat ushtarake të KFOR-it).	Shërbim i obliguar 9 mujor për çdo mashkull mbi 18 vjeç.
Degët ushtarake	Nuk ka. (TMK, forcë civile me armatim të lehtë, me 3.000 trupa)	Ushtria e Serbisë dhe Malit të Zi (Trupat Tokësore, Mbrojtja Ajrore, Forcat Detare) me 2 milionë rezervistë.
Buxheti ushtarak	0 USD	654 milionë USD (2002)
EKONOMIA		
Prodhimi bruto (GDP)	1,8 miliardë USD (2003)	24 miliardë USD (2004)
Të ardhurat për kokë banori (përafërsisht)	850 USD	3.200 USD
Rritja ekonomike	4,5 % (2003)	7,2 % (2004)
Papunësia	42,3 %	18,5 %
Bilanci tregtar (eksporti - importi) (2004)	-1,2 milionë USD	-7 milionë USD
Partnerët tregtarë (për eksport)	Maqedonia 22,7%, Italia 12,3%, Greqia 12,6%, Serbia-Mali i Zi 11%, Shqipëria 10,8%, Gjermania 5,8%, Bosnja 7%	Italia 30,1%, Gjermania 16,6%, Austria 7,4%, Greqia 7,1%, Franca 5,3%, Sllovenia 4,2%, SHBA 4,1%
Buxheti shtetëror (2004)	619 milionë USD	10,5 miliardë USD
Borxhi i jashtëm	0 USD	13 miliardë USD



Foto: Rrezeart Galica - Gqi

Burimet: CIA Factbook, Banka Botërore, Enti Statistikor i Kosovës, Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale (Kosovë), UNMIK, UNDP.

Kjo është një përmbledhje krahasuese e disa informatave kyçe statistikore për Kosovën dhe Serbinë, palë të cilat pritet të negociojnë mbi statusin e Kosovës. Serbia është jo vetëm më e madhe me popullsi dhe territor, por siç shihet nga lartë, ka epërsi të padiskutueshme në organizimin shtetëror, në pozitën ndërkombëtare, në gjendjen relative ekonomike dhe në fuqinë ushtarake. Përveç që gëzon sovranitet të plotë juridik në zbatimin e politikës së brendshme, Serbia ushtron edhe politikë të jashtme autonome, përmes entitetit Serbi-Mali i Zi (SMZ) i cili është shtet i njohur ndërkombëtar, me anëtarësi të plotë në Kombet e Bashkuara. SMZ-ja ka marrëdhënie diplomatike dhe tregtare me një duzinë shtetesh në botë. Në anën tjetër, Kosova mbetet e administruar nga OKB-ja, e

cila kontrollon gjyqësinë dhe policinë, si dhe ruan të drejtën e vetos mbi vendimet e Qeverisë dhe ligjet që nxjerr Kuvendi i Kosovës. Kosova nuk ka politikë zyrtare të jashtme meqë nuk është vend sovran. Ajo nuk zbaton marrëdhënie diplomatike dhe nuk ka përfaqësi ndërkombëtare askund. Juridikisht, marrëdhëniet ndërkombëtare të Kosovës janë kompetencë e rezervuar e UNMIK-ut. Kjo do të thotë se përderisa liderët politikë kosovarë mbajnë lidhje kontakti me shtetet perëndimore dhe organizata ndërkombëtare, ata nuk kanë të drejtën e nënshkrimit të pakteve dhe marrëveshjeve ndërkombëtare, formimin e aleancave dhe anëtarësimin e Kosovës në organizata ndërkombëtare. Kjo përfshin edhe anëtarësimin e mundshëm të Kosovës në Bashkimin Evropian (BE).

Kosova gjithashtu nuk ka forca ushtarake pasi që mbetet nën kontrollin ushtarak të KFOR-it. TMK-ja është trupë pakrahasimisht e vogël (me rreth 3.000 pjesëtarë), dhe si forcë për intervenim në emergjencë civile, posedon vetëm armatim të lehtë. Ky përbën një dallim drastik në raport me Serbisë, e cila ka në disponim afër 2 milionë rezervistë dhe tri degë të forcave të organizuara ushtarake - forcave tokësore, ajrore dhe atyre detare. Megjithatë në krizë ekonomike, Serbia gjendet në një pozitë relativisht më të volitshme ekonomike se Kosova. Papunësia zyrtare është përgjysmë më e vogël se në Kosovë, ekonomia e saj është më e fuqishme, si me prodhim bruto ashtu dhe me të

ardhura për kokë banori, sikurse që edhe në listën e partnerëve të saj tregtarë dominojnë vendet e BE-së, në krahasim me Kosovën ku dominojnë shtetet e Ballkanit. Serbia gjithashtu ka marrëdhënie eksporti me SHBA-të, të cilat Kosova nuk i ka. Edhe rritja ekonomike në Serbi, në vitin 2004, ishte më e madhe se ajo e Kosovës në vitin 2003 (e dhëna që kemi në dispozicion), që tregon se ekonomia e Serbisë është në kahe të rimëkëmbjes shumë më të shpejtë se ekonomia e Kosovës, përkundër imazhit që ka si vend i investimeve të mëdha nga donatorët ndërkombëtarë dhe vetë kosovarët. Sipas tabelës, një problem i ekonomisë së Serbisë është se ka një bilanc të lartë

negativ tregtar, meqë sikurse Kosova, importon më shumë se që eksporton. Sidoqoftë, ekonomia më e madhe i mundëson shtetit serb që të ketë edhe buxhet më të madh shtetëror. Në vitin 2004, ky buxhet ishte 10,5 miliardë USD, i cili në krahasim me Kosovën ishte 17 herë më i madh. Kosova ka epërsi të vetme në faktin që nuk ka borxhe ndërkombëtare. Ndërsa, borxhi ndërkombëtar i Serbisë është 13 miliardë USD. Mirëpo kjo është pasojë e faktit se Kosova, si pasojë e mospasjes së statusit, nuk ka të drejtë të marrë kredi nga institucionet financiare ndërkombëtare.

Besnik Pula

Faturimi dhe 'madhështia' politike

Gëzim Krasniqi

Në procesin e përcaktimit të statusit politik të Kosovës, bashkësia ndërkombëtare i ka legjitimuar udhëheqësit partiakë dhe institucionalë të Kosovës si partnerë për negociata me Serbinë. Më shumë sesa për farë çështje kurtoazie dhe respekti të ndërsjellë institucional (IPVQ-të nuk janë institucione me fuqi reale politike), një zgjedhje e tillë bëhet për çështje kryekëput praktike dhe të interesave politike. Konkretisht, një zgjedhje e tillë bëhet për arsye të amortizimit më të lehtë të vullnetit të qytetarëve të vendit tonë për çlirim dhe liri. Sepse, bëhet fjalë për institucione që u krijuan për të qenë të dështuara, të korruptuara dhe, rrjedhimisht të shantazhuara nga UNMIK-u dhe bashkësia ndërkombëtare. Tërë ideja është që të vazhdohet më realitetin iluzor të filluar më 1999 në Kosovë, përmes të cilit realitet synohet të arrihet deri te ndonjë zgjidhje më lehtë e imponueshme për Kosovën. Liderët politikë dhe institucionalë të Kosovës po e mundësojnë këtë.

Kryekëput të çorientuara politikisht dhe të mbërthyer brenda një sistemi, sa kleptokratik aq edhe antidemokratik e antipopullor, partitë politike të vendit tonë dhe liderët e tyre, gjithë veprimtarinë dhe pritjet e tyre përkitazi me përcaktimin e statusit politik të Kosovës, i kanë reduktuar në procesin e faturimit politik. Për ta, s'kanë rëndësi procedurat, s'kanë rëndësi aspektet ligjore të së drejtës ndërkombëtare, premisat politike para bisedimeve, parimet e panegociueshme, apo vetë sovraniteti i vendit tonë. Për ta, më rëndësi është fatura - dhe që mundësisht, në të, të përmendet në një mënyrë apo tjetër fjala 'pavarësi'. Fatura është me rëndësi jetike për partitë politike dhe liderët aktual politikë në Kosovë, për së paku dy arsye. E para, sepse duke 'poseduar' një faturë politike për statusin e Kosovës, ata përpiqen të shfaqin 'madhështinë' e tyre politike dhe rolin e tyre 'historik' në zhvillimet politike në vendin tonë. Pozita dhe opozita ngarendin se kush e para do ta sigurojë këtë faturë (fillon loja politike me rezolute e projektushtetuta). E dyta, përmes sigurimit të kësaj fature politike ata përpiqen të sigurojnë jetëgjatësinë e tyre politike; sepse ndryshe, ata e dinë që janë të konsumuar dhe të mbaruar politikisht.

Këto qëllime politike, sado meskine dhe qëllimliga, do të 'arsyeto-heshin' sikur fatura politike për të cilën bëhet fjalë, do të kishte vlera



të vërteta politike dhe të ishte në përputhje me vullnetin e popullit. Krejt ndryshe, fatura politike që po bëhet gati për Kosovën, është pakrahasimisht larg të qenurit kapital politik i mjaftueshëm për të qenë shtet sovran. Kjo për faktin që zhvillimet politike drejt përcaktimit të statusit politik të vendit tonë, janë negative dhe të pafavorshme për ne. Pra, premisat janë negative. Rrjedhimisht, edhe përfundimi do të jetë i tillë, veçse në mënyrë që t'i bëhet ballë pakënaqësisë qytetare dhe të arrihet të amortizohet vullneti i popullit, faturimi është paraparë të jetë përshkrim joreal i marrëdhënieve të ndërsjella (politike). Me përkufizimin 'pavarësisë së kushtëzuar', popullit të Kosovës do t'i mohohet liria dhe sovraniteti; me përkufizimin 'decentralizim dhe reformë e pushtetit lokal', Kosovës do t'i pamundësohet funksionaliteti dhe tërësia territoriale; me përkufizimin 'monitorim ndërkombëtar' qytetarëve të Kosovës do t'u pamundësohet e drejta për të përcaktuar vetë të ardhmen e tyre...

'Madhështia' politike e partive në Kosovë dhe liderëve të tyre realisht është rezultat i pasurimit të tyre marramendës në kurriz të popullatës vendase, të dërrmuar nga gjendja e rëndë sociale dhe politike. Me aq pak pushtet sa iu mundëson UNMIK-u, ata shpërfaqin gjithë grykësinë e tyre për pushtet dhe përfitime, pale çfarë është gjendja e përgjithshme politike dhe sociale në vend. Për ta, progresi i përgjithshëm matet me kapitalin e tyre të rrejshëm politik, si dhe rritjen e pasurimit të tyre personal, grupor dhe partiak. Pasuria e tyre ua krijon një vel (xhamat e zi të veturave të tyre luksoze) që iu pamundëson ta shohin gjendjen e rëndë socio-

ekonomike dhe mjerimin përreth. Gjithë maniret e tyre dhe grykësia për pushtet dhe përfitime, janë të orientuara drejt përvetësimit të asaj çka është e vendit dhe popullit tonë, dhe që eventualisht iu mundësohet nga UNMIK-u. Njëjtë siç shprehet Franc Fanoni për rastin e Algjerisë së kolonizuar: korbat janë bërë të shumtë dhe tepër grykës në krahasim me ligështinë e presë kombëtare.

Të shastisur dhe mahnitur nga ushtrimi diktatorial i pushtetit nga UNMIK-u, liderët e IPVQ-ve dhe partive politike, me të madhe përpiqen që të imitojnë sjelljen politike të udhëheqësve ndërkombëtarë në Kosovë, pa e pas kuptuar që me një veprim të tillë nuk shndërrohen madje as në kopje të tyre. Ata po shndërrohen në karikaturë. Karikaturë brenda kornizave të caktuara nga UNMIK-u. Si të tillë, ata ngarendin pas pushtetit dhe faturimit politik fals. Faturimi dhe fatura politike nuk janë të tilla në vetvete, të shkëputura nga marrëdhëniet e caktuara politike. Ato kanë kuptim vetëm nëse pasqyrojnë realisht një marrëdhënie. Në Kosovë, faturimi politik që po synohet të arrihet me rastin e definimit të statusit politik, sipas të gjitha gjasave pritet të jetë i emërtuar në një mënyrë që bren-dapërbrenda përmban fjalën 'pavarësi', pa marrë parasysh me sa para- apo prapa-shtesa. Por, në realitet, ajo nuk pritet të ketë ndonjë vlerë të madhe politike, apo të garantojë shkëputjen përfundimtare të Kosovës nga Serbia. Me kohë, edhe ajo faturë do të vjetërsohet, dhe partive politike dhe liderëve aktualë të Kosovës s'do t'u mjaftojë më. Do kërkojnë një tjetër, nëse rrjedha e ngjarjeve veç nuk i ka hedhur tutje.

Bërns, Haradinaj dhe Rupe

Shkëlzen Gashi

1. Nënsekretari amerikan i shtetit, Nikolas Bërns, me rastin e vizitës së tij në Kosovë, tha se rezultatin e statusit final të Kosovës do ta sjellë kompromisi mes udhëheqësve të Kosovës dhe Qeverisë së Serbisë dhe Malit të Zi. Ai po ashtu tha se për statusin e Kosovës do të vendosin qytetarët e Kosovës. Kjo është kontradiktore. Kompromisi nënkupton që të dyja palët të lëshojnë pe nga qëndrimet e tyre fillestare. Kjo do të thotë që të shkelet vullneti i qytetarëve të Kosovës. Për më keq, Bërns tha se serbët kanë mbetur të vendosin mes pjesëmarrjes në ekipet e Prishtinës, Beogradit apo të krijojnë ekip të veçantë. Pra, ShBA-të, janë në favor të idesë që Kosova t'i ketë dy ekipe nëse kështu vendosin serbët e Kosovës. Gjatë vizitës së tij në Kosovë, Bërns dëshmoi se për SHBA-të është e rëndësishme që gjatë dhe pas negociatave të ketë paqe dhe stabilitet në Kosovë. E, siç dihet, stabiliteti për bashkësinë ndërkombëtare ruhet vetëm duke mos u ndryshuar kufijtë shtetëror në Ballkan, pra që kufiri mes Kosovës dhe Serbisë të mbetet kufi administrativ, ashtu siç edhe është aktualisht.

2. Tribunali i Hagës i lejoi Ramush Haradinajt të kthehet në politikë, për ta pezulluar pastaj vendimin për disa ditë. Por, vetëm aq sa UNMIK-u vlerëson se ai mund të jetë i rëndësishëm për zhvillimet pozitive politike dhe të sigurisë në Kosovë. Zhvillimet pozitive politike në Kosovë për UNMIK-un janë jetësimi i decentralizimit, si parakusht për negociatat dhe vetë negociatat. Ka shumë gjasa që Ramush Haradinaj do ta vlerësojë raportin e Aides si pozitiv dhe ta mbështes plotësisht! Pas këtij vendimi të Tribunalit të Hagës, Haradinaj pas një takimi me Kryetarin e Kosovës, Ibrahim Rugova, ka deklaruar se do të vazhdojë të mbështes punën e mirë që ka filluar dhe po bëhet në Kosovë. Në Kosovë nuk është duke u bërë punë e mirë, sepse po përgatiten negociatat për statusin e Kosovës, e të cilat do të çojnë në kompromis. Ka gjasa që Ramush Haradinaj do të jetë pjesë e ekipit negociator. Kështu si po manipulohet me Ramush Haradinajn ka gjasa që të manipulohet edhe me komandantë të tjerë të shquar të UÇK-së, po qe se hetohet se ata kanë autoritet siç ka Haradinaj në rrafshin e Dukagjinit.

3. Kryesuesi i OSBE-së dhe njëkohësisht shefi i diplomacisë së Sllovenisë, Dimitrij Rupe, ka deklaruar sot në Beograd se bashkësia ndërkombëtare duhet t'u garantojë serbëve të drejtën që të kthehen në Kosovë, atje ku ata dëshirojnë të jetojnë, dhe ka vënë në dukje se në procesin e decentralizimit në Kosovë duhet formuar "zinxhirin e komunave serbe të cilat do të kishin lidhje speciale me Serbinë". Kjo është në përputhje me raportin e Aides. Kosova nuk do të jetë e pavarur dhe sovranë. Serbia nuk synon që ta ndajë Kosovën në dy pjesë - pjesën serbe ta marrë, ndërsa pjesën shqiptare ta lejojë që të jetë e pavarur dhe sovranë. Serbia synon që para se ta rimarrë Kosovën, ta copëtoj atë. Ky synim i Serbisë është i shtjelluar në planin 14 faqesh të Ministrisë të Punëve të Jashtme të Unionit Serbi-Mali i Zi, Vuk Drashkoviç, ku parashihet që Kosova të ketë autonomi substanciale në kuadër të Unionit Serbi-Mali i Zi, ndërsa serbët e Kosovës autonomi në kuadër të autonomisë substanciale.

NEGOCIATAT - "exit strategy" e rrezikshme e UNMIK - ut

Agron Demi

Administrimi i UNMIK-ut në Kosovë, sipas teorisë së administrimeve ndërkombëtare, është i tipit të administratave transnacionale - UNTA (United Nations Transit Administrations). Por, që nga aplikimi i saj në Kosovë, në praktikë UNMIK-u nuk i është përmbajtur përkufizimit të tij teorik, ngase vendosi administrimin e tij në Kosovë duke lënë anash elementin përbërës dhe më të rëndësishmin për funksionimin e administrimeve ndërkombëtare - strategjinë dalëse (exit strategy). Më saktësisht, UNMIK-u nuk e bëri transparent strategjinë dalëse nga Kosova. Strategjia dalëse e një administrimi ndërkombëtar duhet të përcaktohet njëkohësisht me strategjinë hyrëse. Strategjia dalëse është faza e fundit e një administrimi ndërkombëtar, faza dhe koha kur një administrimi duhet t'i vijë fundi. A mund të besohet se UNMIK-u e harroi këtë element të funksionimit të tij? Ai këtë element nuk e harroi, por nuk e bëri transparent, dhe me mos bërjen transparent të strategjisë dalëse, UNMIK-u që në fillim, ende pa hyrë në Kosovë, shkeli të drejtën e popullit të Kosovës për ta informuar atë drejt për misionin dhe qëllimin e tij.

Me drejtimin e Kosovës drejt negociatave dhe me përgatitjen e liderëve vendorë për të negociuar, UNMIK-u njëkohësisht zbuloi edhe strategjinë dalëse të tij. UNMIK-u është deklaruar se me zgjidhjen e statusit final të Kosovës,



misioni i UNMIK-ut në Kosovë do të përfundojë. Statusi final sipas UNMIK-ut duhet të zgjidhet përmes negociatave. Sipas kësaj rrjedhe, negociatat njëkohësisht janë edhe strategji dalëse e UNMIK-ut nga Kosova. Kjo strategji dalëse nuk erdhi rastësisht dhe si rezultat i rrjedhave politike, por ishte e planifikuar qysh me strategjinë hyrëse, ngase për gjashtë vite UNMIK-u e udhëhoqi Kosovën drejt negociatave. Përse UNMIK-u nuk e bëri transparent para gjashtë viteve strategjinë dalëse? Kjo, ngase po t'u thuhej shqiptarëve para gjashtë viteve se statusi i tyre politik do të zgjidhet përmes negociatave me Beogradin, UNMIK-u nuk do të pranohej nga pop-

ulli i Kosovës aq përzemërsisht siç është pranuar. UNMIK-u për gjashtë vite përgatiti liderët kosovarë në drejtim të negociatave, dhe tani si rezultat i punës së tij ka formuar grupin 'ideal' negociator, që nuk mund të bëjë asgjë më tepër përveçse t'u shërbejë interesave të UNMIK-ut.

Por a duhet që shqiptarët e Kosovës t'i pranojnë këto rrjedha politike? Cili shqiptar i Kosovës do të pranonte para gjashtë viteve se fati i vendit të tij/saj do të varej përsëri nga bisedimet me Beogradin dhe nga vullneti i këtij të fundit? Përse tani të pranohet kjo gjë? Për gjashtë vite a është relativizuar dëshira për pavarësi? Nëse negociatat janë një gjë pozitive, përse

nuk u bë transparente para gjashtë viteve nga ana e UNMIK-ut se strategjia dalëse e UNMIK-ut është zgjidhja e statusit final të Kosovës përmes negociatave

me Beogradin, dhe se për statusin final nuk do të vendosë populli i Kosovës, por rezultati i negociatave? Me vite të tëra Kryetari i Kosovës ka apeluar për njohje formale të pavarësisë së vendit tonë. Përse tani doli që pavarësia nuk qenka edhe aq formale? Përse u dashka të negociohet për këtë formalitet? Kryeministri i tanishëm i Kosovës, pak ditë pas marrjes së detyrës, pat deklaruar se nuk do ta pyes Beogradin se si duhet të jetojnë fëmijët e tij në Kosovë? Përse tani ai pranon të negociojë për këtë? Përse populli i Kosovës duhet t'iu besoj liderëve të tyre kaq labil? Çdo qytetar i Kosovës është përgjegjës për rezultatet e ardhshme politike, ngase moskundërshtimi i negociatave është aprovim në mënyrë pasive. Shanset që Kosova të fitojë pavarësinë janë pakrahasimisht më të mëdha n.q.s. populli tani ngritet dhe vetëvendosë për fatin e tij politik, se sa që kjo gjë do të arrihet përmes negociatave me Beogradin.



Lëvizja VETËVENDOSJE! është komunitet i njerëzve që refuzojnë të nënshtrohen. Ajo synon arritjen dhe realizimin e vetëvendosjes për popullin e Kosovës. Lëvizja VETËVENDOSJE! angazhohet edhe për ndryshime radikale shoqërore e politike që do të mundësonin respektimin e të drejtave të njeriut, të drejtave civile dhe drejtësisë sociale për të gjithë dhe secilin në Kosovë pa kurrfarë diskriminimi.

VETËVENDOSJE!

**KOPJIMI LEJOHET.
TË LUTEM KOPJOJE!**

Rr. Perandori Justinian, p. n.
Qyteza Pejton
Prishtinë, Kosovë

038 222 704
vetevendosje@hotmail.com
vetevendosje@yahoo.com
vetevendosje@gmail.com
www.vetevendosje.org